



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



Nr. 36 prot

01/13/11/2023

VENDIM

Nr. 27, datë 09.11.2023

PËR

**SHTYERJEN E PROPOZIMIT PËR MIRATIMIN E KËRKESËS
PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA SHOQËRIA “W.T.S-
ENERGJI” SH.P.K TEK SHOQËRIA “SELCA ENERGJI” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, dhe në nenin 20 pika c) të Rregullores së Keshillit të Basenit Ujor

V E N D O S I:

1. Shtyerjen e propozimit për miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.8, datë 10.06.2013 “Leje për përdorim rezerve ujore për prodhim energjie, HEC VUKLIT”
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

